



BASHKIA
TIRANË

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 88, datë 26.07.2017

PËR

**“ NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 41, DATË 23.09.2015 TË KËSHILLIT BASHKIAK
“PËR RIORGANIZIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME NR.1 TË PUNËTORËVE
TË QYTETIT DHE KRIJIMIN E AGJENCISË SË PARQEVE DHE REKREACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b), nenit 25, pika 4, nenit 33, pika 1, shkronja (a), nenit 54, shkronja (k) dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 8, pika 3 të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”; vendimit nr. 84, datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017” të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Në pikën 2 të vendimit nr. 41, datë 23.09.2015 të Këshillit Bashkiak “Për riorganizimin e Drejtorisë së Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit dhe Krijimin e Agjencisë së Parqeve dhe rekreacionit” shtohen shkronjat (e) dhe (f), me këtë përmbajtje:

“e. Administrimi i asetëve rekreative e sportive (terrene, kënde, salla, pishina, fusha, palestra, sheshe, vegla e pajisje, pista e shtigje, ambiente rekreative e sportive) që ndodhen në territorin e Bashkisë Tiranë.

“f. Nxitja, promovimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve rekreative e sportive për fuqizimin e jetesës aktive nëpërmjet edukimit e sensibilizimit për një jetesë të shëndetshme.”

2. Ngarkohet Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI